



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I.-22-0499

Në ankesën e

Paditësit/ Ankuesit

M V etj, të cil cilët i përfaqëson avokat O C nga Peja.

Kundër:

E paditura

NSH "Bujqësia"(në likuidim), e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit, (AKP)**, Rruga, "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj, dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësve, të parashtruar kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III-15-0769, të datës 18 maj 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 25 korrik 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësve refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktvendimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së C-III-15-0769, i datës 18 maj 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me 06 nëntor 2015, paditësit në DHPGJS kanë parashtruar ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) për NSH „ Bujqësia” PEJ055-0078, me të cilin është refuzuar kërkesa pronësore për ngastrat nr., me sipërfaqe 5,19.44 ha, ngastra nr.67/1 dhe 71/34 me sipërfaqe prej 81.13 ha dhe nr.. me sipërfaqe pre 2,54.51, ha dhe kompensimi prej 1,500.00 euro. Kërkesës nuk iu është bashkangjitur asnjë provë, as Vendimi i Autoritetit të Likuidimit.

Më 15 janar 2016, AKP ka dorëzuar parashtresën në mbrojtje ndaj ankesës kundër Vendimit PEJ035-0078, me propozim që ankesa të refuzohet dhe të vërtetohet Vendimi i AL. Parashtresës në mbrojtje ja ka bashkangjitur: Vendimin për fillimin e likuidimit, datë 06 qershor 2004, formularin e kërkesës kreditore, datë 25 korrik 2014, aktgjykimin e Gjykatës Qarkut në Pejë, datë 15 mars 1998, Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, KAC.nr.3/2010, datë 14 shkurt 2011, me të cilën është refuzuar ankesa e AKP-së, ndërsa aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë AC 389/2009, datë 09 nëntor 2010 është vërtetuar, Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë AC nr.389/09 dt. 09 nëntor 2010, me të cilën ishte hedhur poshtë si e pasafatshme propozimi për përsëritje të procedurës, aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Pejë C.nr.593/94, i datës 25 qershor 1997, i bërë i formës së prerë me datë 16 mars 1998, autorizimin për përfaqësim të palës datë 29 dhjetor 2003, aktvendimin për trashëgimi të Gjykatës së Rrethit Pejë, t.56/59.

Më 18 prill 2017, i autorizuari i paditësit e ka dorëzuar parashtresën me të cilën është deklaruar se sipas aktvendimit për trashëgimi nr.383/2017, datë 14 prill 2017, pas vdekjes së B S V sipas të cilit si trashëgimtar janë shpallur M dhe P si dhe mbesa S V dhe S S sipas të drejtës së përfaqësimit për babin e tyre P. I njëjti përveç pretendimeve të tija të cekura si në kërkesën kryesore ka theksuar se ka iniciuar procedurën gjyqësore për dorëzimin e paluajtshmerivë para Gjykatës Komonale në Pejë, po kjo Gjykatë me Aktvendimin C.Nr.785/06, është shpallur jo kompetente dhe shkresat ja ka bartur në Dhomë të Posaçme të Gjykatës Supreme. Më tej ka theksuar se

III

kontesti po zgjat shumë ashtu që AKP-ja mund ti ketë shitur këto prona dhe paditësit të kenë pësuar dëm të pa riparueshëm, për shkak të shitjes së pronave që sipas Aktgjykimit C,nr.593/94, kontratat janë anuluar dhe ka propozuar caktimin e një eksperti për vlerësimin e paluajtshmerivë.

Më 06 prill 2022, Gjyqtari i shkallës së parë ka lëshuar Urdhër C-III-15-0769, për të autorizuarin e paditësit me të cilin ka kërkuar të plotëson ankesën e ushtruar kundër Vendimit të autoritetit të Likuidimit, sikundër i ka kërkuar të dorëzon një kopje të vendimit të Autoritetit të Likuidimit dhe të paguajë taksën gjyqësore. I autorizuari i paditësve është njoftuar edhe më pasojën juridike të mos pagesës së taksës gjyqësore.

Më 22 prill 2022, me parashtresë i autorizuari i paditësve përveç pretendimeve lidhur me paluajtshëmrin kontestues ka kërkuar bashkimin e lëndëve C-III-0390 dhe C-III-15-0769, duke marrë për bazë se palët janë të njëjta dhe objekti është i njëjtë por me këtë parashtresë nuk ka dorëzuar dëshminë për pagesën e taksës.

Më 18 maj 2022, shkalla e parë e DHPGJS ka marrë Aktvendim me të cilën ankesa e paditësve M V etj, e ka konsideruar të tërhequr për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore. Në arsyetim të Aktvendimit thuhet se i autorizuari i paditësve, nuk e ka paguar taksën gjyqësore dhe nuk e ka dorëzuar një kopje të vendimit të Autoritetit të Likuidimit kundër të cilit është ushtruar kërkesa/ankesa, ashtu siç është paraparë me nenin 74.2 të ligjit nr.06/L-086.

Në arsyetim të aktvendimit shkalla e parë ka arsyetuar se duke u bazuar në nenin 5.5.2 të udhëzimit Administrativ nr.01/2017, ka hyrë në fuqi më 01 maj 2017, për aplikimin e njëjtë të taksave gjyqësore, paditësit i kërkohet që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga të shërbyerit dhe pranimit i urdhrit të gjykatës për t'ia dorëzuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës vërtetimin dhe faturën e pagesës të shumës së caktuar që duhet paguar ose të t'ia dorëzojë gjykatës prova në lidhje me faktin se ai është

IV

liruar nga pagesa për arsye se është përfitues i ndihmës sociale nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose Agjencia për Ndihmë Juridike .

Udhëzimi administrativ nr.01/2017, për Unifikimin e tarifave gjyqësore, neni 5 paragrafi 5.1, parashikon detyrimin e të gjithë atyre që i drejtohen Gjykatës për të paguar taksat gjyqësore, ashtu që sipas nenit 13.1 dhe 13.4 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017, për unifikimin e taksave gjyqësore është caktuar taksa në lartësi 100 euro. Për më tepër, Udhëzimi Administrativ nr.01/2017, neni 5.5.2 parasheh që, " nëse pas njoftimit, pala nuk e paguan taksat gjyqësore, sipas nenit 5.1 të këtij Udhëzimi, gjyqtari i caktuar për çështjen do të aplikojë nenin 253, paragrafi 5 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe si pasojë padia do të konsiderohet e tërhequr.

Shkalla e parë ka theksuar se meqenëse paditësit/ i autorizuari, kishte pranuar Urdhrin për pagesën e taksës gjyqësore dhe kjo rrethane vërtetohet nga fletë dorëzimi më datë 15 prill 2022, ndërsa afati për pagesë ka qenë deri më datë 03 maj 2022, paditësit/ i autorizuari nga data 16 prill 2022 e deri në ditën e marrjes së vendimit nuk e ka dorëzuar dëshminë për pagesën taksës gjyqësore, sikundër nuk ka ushtruar as kërkesë për zgjatje të aftit për pagesën e taksës gjyqësore, kështu që në kuptim të dispozitës së nenit 253.5 të LPK-së, gjykata ankesën e ankuesit e konsideroi të tërhequr.

Me 25 gusht 2022, paditësi nëpërmjet përfaqësuesit për mes postës e dërgon në DHPGJS një ankesë kundër Aktvendimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-III-15-0769 të datës 18 maj 2022, për shkak të gjitha arsyeve ankimore me të cilën ka propozuar Anulohet Aktvendimi i Dhomës së Posaçme C-III-15-0769 datë 18 maj 2022 dhe lënda ti rikthehet të njëjtës shkallë në rivendosje. Ka theksuar se Aktvendimi i refuzuar shkallës së parë është i paqartë, kontradiktor në çështjet themelore dhe juridike. Më 15 gusht 2022, autorizuesi i paditësit ka pranuar Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës me numrin e mësipërm të datës 18 maj 2022. Në këtë rast, përfaqësuesi ka theksuar se pala ka bërë ankesë fillestare më 06 nëntor 2015. Kanë kaluar 6 vite, 4 muaj e 6 ditë pa asnjë veprim ligjor apo

procedural nga gjyqtari kompetent për këtë çështje.

Pas skadimit të afatit të caktuar prej 6 vitesh, 4 muajsh dhe 6 ditësh, Gjykata e njoftoi autorizuesin e palëve që pala duhet ta paguajë tarifën gjyqësore në afat prej 15 ditësh, gjegjësisht sipas praktikës kosovare, pala duhet të vijë-të-udhëton në Prishtinë në objektin e Gjykatës Supreme të Kosovës, me qëllim të pagesës së tarifës gjyqësore me vërejtje se ankesa do të hedhet. Autorizuesi i paditësve ka dërguar një shkresë më 22.04.2022 të cilën e ka dorëzuar drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, sipas së cilës gjykata nuk ka vepruar fare, dhe nga përmbajtja e arsytimit shihet qartë se nuk ka vepruar e lexuar në tërësi, nuk është kuptuar ose nuk është përkthyer në mënyrën e drejtë. Me këtë parashtresë, përfaqësuesi ka theksuar se në të njëjtën gjykatë do të fillon procedura për të njëjtën lëndë për të njëjtën çështje ndërmjet palëve me numrin e lëndës C-III-12-0390. Me këtë shkresë gjyqtari, i çështjes njoftohet me parashtresën me shkrim për parashtresën e mëparshme dhe kërkohet nga gjykata që të kontrollohet -verifikohet nëse kjo procedurë është e bashkuar apo nëse bëhet fjalë për dy procedura të veçanta. Në të kundërtën, në aktvendimin e atakuar janë refuzuar fakte të pasakta dhe të pakonfirmuara, krejtësisht pa mbështetje në shkresat, të cilat e bëjnë aktvendimin të pakuptueshëm dhe tërësisht të kundërligjshëm. Gjykata është dashur të kontrollojë pretendimet e paditësve, të cilët dukshëm kanë qenë të bazuar dhe është dashur të kontrollohen pretendimet e tilla dhe vetëm atëherë të vërtetohen se pala nuk e ka përmbushur detyrën e pagesës së taksës gjyqësore.

Ka shtuar se ajo e ka paguar një taksë gjyqësore për një lëndë dhe se ajo ka dy lëndë C-III-12-0390 dhe C-III-15-0769, kështu që është logjike që nëse është e njëjta lëndë atëherë paguhet një tarifë. Në tërësi, në arsytimin e aktvendimit, gjykata vetëm ka përmendur-cituar përmbajtjen e shkresave të lëndës dhe ka konstatuar se tarifa nuk është paguar dhe në këtë mënyrë "e ka zgjidhur lëndën" pa u lëshuar- hyrë në çështjen juridike dhe procedurale të palës.

Një çështje e tillë e komplekse e së drejtës juridike, si dhe kohëzgjatja e pritjes për zgjidhjen e çështjes nga gjykata, e cila vonohet me të paktën 6 vjet e 6 muaj, sipas parimeve të drejtësisë, nuk i jep të drejtë gjykatës të deklaroj me një fjali se padia është tërhequr në tërësi, duke dhënë njëkohësisht arsye krejt të paligjshme, të paqarta dhe kontradiktore për vendimin e tij vetëm me qëllim zgjidhjen e shpejte të çështjes për të cilën palët presin prej 6 e gjysme viti.

Me 21 dhjetor 2023, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës paditësve. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditësit si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e paditësve refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai vërtetohet.

VII

Kolegji i Apelit vëren se paditësit në DHPGJS kanë dorëzuar një kërkesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit për NSH „ Bujqësia” PEJ 055-0078, me të cilin është refuzuar kërkesa pronësore për ngastrat nr.70/1, me sipërfaqe 5,19.44 ha, ngastra nr.67/1 dhe 71/34 me sipërfaqe prej 81.13 ha dhe nr.20 me sipërfaqe,2,54.51, ha dhe kompensimi prej 1,500.00 euro. Kërkesës nuk ja ka bashkangjitur asnjë provë, pra as Vendimin e Autoritetit të Likuidimit kundër të cilit është ushtruar kërkesa e që ka pasur për obligim ta dorëzoi.

Shkalla e parë e DHPGJS-së ka marrë Aktvendim me të cilën ankesa e paditësve M V etj, e ka konsideruar të tërhequr për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore. Në arsyetim të Aktvendimit është konstatuar se paditësi/ i autorizuari, kishte pranuar Urdhrin për pagesën e taksës gjyqësore dhe kjo rrethane vërtetohet nga fletë dorëzimi më datë 15 prill 2022, ndërsa afati për pagesë ka qenë deri më datë 03 maj 2022, paditësi/ i autorizuari nga data 16 prill 2022 e deri në ditën e marrjes së vendimit nuk e ka dorëzuar dëshminë për pagesën taksës gjyqësore, sikundër nuk ka ushtruar as kërkesë për zgjatje të aftit për pagesën e taksës gjyqësore, kështu që në kuptim të dispozitës së nenit 253.5 të LPK-së, Shkalla e parë ankesën e ankuesit e kishte konsideruar të tërhequr.

Kolegji i Apelit vëren se paditësit pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme kanë qenë duke zhvilluara dy procedura gjyqësore, ku njëra lëndë ishte e regjistruara si C-III-12-0390 (kthyer në rigjykim dhe ka numër te ri C-III-17-0075), ndërsa lënda që është objekt i këtij kontesti ishte e regjistruara si lëndë C-III-15-0769.

Është i saktë pohimi i paditësve se ata kishin dy lëndë në DHPGJS, por është i pabazuara dhe nuk qëndron pretendim i paditësve se me një pagesë të bërë për taksë gjyqësor ata kanë përmbushur obligimin për taksë. Kolegji i Apelit me kujdes të veçantë ka shikuar shkresat e lëndës dhe vëren se paditësit nuk kishin përmbushur urdhrin e gjykatës, me të cilin atyre u ishte kërkuar pagesa e taksës gjyqësore në rastin C-III-15-0769. Kolegji i Apelit nuk e përjashton

VIII

mundësin që paditësit mund të kenë bërë pagesën e taksës gjyqësore për rastin tjetër (në periudhë tjetër kohore) ngritur në lëndën C-III-12-0390, por ajo nuk e mbulon taksën gjyqësore për çështjen juridike për lëndën C-III-15-0769, i cili ishte në zhvillim e sipër dhe për të cilin Shkalla e parë kishte lëshuar urdhër të veçantë për pagës të taksës me nr. të lëndes C-III-15-0769.

Po ashtu është i pabazuar edhe perëndimi tjetër i paditësve se ata kanë pritur që të bashkohen procedurat gjyqësore. Deri sa për këtë çështje gjyqësore rreth bashkimit të lëndëve gjykata nuk ka marrë vendim gjyqësor, paditësit është dashur ti përgjigjen urdhrin të gjykatës për pagesën e taksës gjyqësore, prandaj pretendimi paditësve në këtë aspekt është i pabazuar.

Andaj Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e shkallës së parë e cila ka vlersuar paditësit/ i autorizuari, kishte pranuar Urdhrin për pagesën e taksës gjyqësore dhe kjo rrethanë vërtetohet nga fletë dorëzimi më datë 15 prill 2022, ndërsa afati për pagesë ka qenë deri më datë 03 maj 2022. Po ashtu Kolegji vëren se paditësit nuk kishin ushtruar as kërkesë për zgjatje të aftit për pagesën e taksës gjyqësore, dhe madje në parashtresën e tyre të dt. 22 prill 2022, nuk e kishin ngritur fare çështjen e taksës, kështu që në kuptim të dispozitës së nenit 253.5 të LPK-së, me të drejte Shkallë e parë ankesën e paditësve e ka konsideruar të tërhequr.

Andaj nga këto arsye, rezultati i dhënë me Aktvendimin e ankimuar nuk ka mundësi të ndryshohet, prandaj ankesa e paditësve refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Prandaj nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksa gjyqësore

Paditësit e kanë paguar taksën gjyqësore më 08 shtator 2022 në shumë prej 100 euro, andaj nuk caktohen taksa shtesë.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së 25 korrik 2024

Mr. Sc Sahit Sylejmani , Gjyqtar Kryesues
